



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 201, Datë 27.09.2024

MBI

ZGJATJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT LIDHUR ME KËRKESËN E
SHOQËRISË “ALBANIA POWER CORE” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.09.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1662/8 prot., datë 24.09.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Albania Power Core” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Albania Power Core” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662 prot., datë 19.07.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 40.56 MW, në Fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 153, datë 31.07.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 01.08.2024 dhe 02.08.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.08.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu me shkresën nr. 1662/4 prot., datë 06.08.2024, ERE ka njoftuar dhe MIE-n mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.
- Me shkresën me nr. 1662/3 prot., datë 06.08.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës si dhe i ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të plotësuar pjesërisht, që lidhej me dokumentacion vërtetues të mbështetjes financiare dhe fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit.
- Në përgjigje, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1662/5 prot., datë 15.08.2024 dhe nr. 1662/7 prot., datë 11.09.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit,

nga shqyrtimi i të cilit rezulton se ka nevojë të sqarohet/plotësohet më tej dokumentacioni për mbështetjen financiare për realizimin e projektit fotovoltaik.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, parashikohet se bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.
- Me qëllim që shoqëria të sqarojë e të depozitojë në vijim në ERE dokumentacionin e munguar, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Albania Power Core” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Albania Power Core” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e këtij vendimi, shoqëria të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Albania Power Core” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI